

**Njoftim i përqendrimit me të cilin OMV Dojçland GmbH nga Gjermania do të fitoj kontrollin e vetëm mbi Valldurn Grundstucks GmbH nga Gjermania**

**(lënda nr. 08-102/ 2023)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 18.07.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të vetëm nga OMV Dojçland GmbH me seli të regjistruar në Heiminger Shtrase 1, 84489 Burghauzen, Gjermani, mbi Valldurn Grundstucks GmbH me seli të regjistruar në Hultshiner Damm 335, 12623, Berlin, Gjermani, nëpërmjet blerjes së 89.9% të aksioneve të Valldurn Grundstucks GmbH nga Gjermania.

**OMV Dojçland GmbH** është një shoqëri e varur indirekte në pronësi të plotë të OMV AG. OMV AG është një shoqëri aksionare e cila është e listuar në bursën austriake. Grupi OMV është aktiv në mbarë botën përmes kërkimit, zhvillimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit. Gjithashtu, operon me rafineri në Austri, Gjermani dhe Rumani që prodhojnë dhe shesin gaz të lëngshëm naftë, kerozin, naftë, benzinë, naftë, karburant ekstra i lehtë, vaj i rëndë, sqfufur dhe koks i kalcinuar; tregton dhe shet gaz; dhe zotëron një rrjet të tubacioneve të gazit dhe objektet e depozitimit të gazit në Austri. Kompania menaxhon 1803 pika karburanti në dhjetë vende evropiane. Nga kimikatet dhe materialet, OMV ofron produkte poliolefine përmes shoqërisë së saj Borealis dhe është aktive në kimikatet bazë, ushqimin e bimëve dhe riciklimin mekanik të plastikës.

-OMV Dojçland GmbH është aktive në riciklimin e kimikateve përmes procesit të saj inovativ ReOil. ReOil është një teknologji e patentuar e riciklimit kimik (procesi i pirolizës) i zhvilluar nga OMV që i kthen mbetjet plastike në vaj pirolizë. Kjo mbetje plastike nuk është e përshtatshme për riciklim mekanik dhe përndryshe do të përfundonte në deponitë ose në djegien e mbeturinave. Prosesi ReOil funksionon nën presion të moderuar dhe temperatura normale të punës së rafinerisë. Vaji i pirolizës, gjegjësisht, nafta e papërpunuar sintetike, mund të përpunohet në çdo produkt të rafinuar të dëshiruar, duke reduktuar kështu varësinë nga burimet natyrore dhe duke përmirësuar intensitetin e karbonit në krahasim me përpunimin e naftës së papërpunuar fosile. Që nga viti 2018, OMV ka operuar një fabrikë pilot ReOil në lokacionin e rafinerisë Shvehat me një prodhim prej 100 kg në orë, e cila është plotësisht e integruar me rafinerinë, funksionon vazhdimisht dhe ka një certifikuar ISCC PLUS. OMV aktualisht po ndërton një fabrikë demonstrimi ReOil në vendin e Shvehatit me një kapacitet vjetor prej 16,000 tonësh, i cili do të jetë funksional deri në fund të vitit 2023.

Shoqëria e varur e OMV- Borealis është aktive në riciklimin mekanik të plastikës përmes shoqërive të varura të saj : Në vitin 2016, Borealis bleu mtm plastics GmbH, e cila ka ricikluar ambalazhe plastike të përdorura në Niedergebra (Gjermani) që nga viti 1994. Mtm plastics është një nga liderët e teknologjisë evropiane në fushën e riciklimit të mbetjeve plastike të përziara dhe prodhon regranula poliolefine me cilësi të lartë për projektet për kallëpe me injeksion. Që nga viti 2018, Borealis ka operuar një fabrikë për prodhimin e riciklimit LDPE me cilësi të lartë nga plastika e ricikluar në Vildon(Austri) përmes shoqërisë të varur të saj Ekoplast.

OMV Dojçland GmbH nuk është e pranishme dhe e regjistruar në ndonjë korporatë në Maqedoninë e Veriut.

- **Valldurn Grundstucks GmbH** me zyrë të regjistruar në Hultshiner Damm 335, 12623, Berlin, Gjermani, është regjistruar në regjistrin tregtar gjerman të Gjykatës së Qarkut të Sharlotenburg me numrin e regjistrimit HRB 234493 B. Shoqëria ende nuk ka asnjë aktivitet biznesi.

OMV Dojçland GmbH dhe ALBA Risajking GmbH ("ALRE") synojnë të ndërtojnë dhe operojnë së bashku një fabrikë klasifikimi për klasifikimin e plastikës së përzier për riciklimin kimik përmes OMV Dojçland GmbH. Për këtë qëllim, Valldurn Grundstucks GmbH u ble nga ALRE nëpërmjet një furnizuesi profesionist të kompanive të gatshme. Aktualisht ALRE zotëron 100% të aksioneve në Valldurn Grundstucks GmbH.

Si pjesë e transaksionit të planifikuar, OMV Dojçland GmbH do të blejë 89.9% të aksioneve dhe në këtë mënyrë do të fitoj kontrollin e vetëm mbi OMV Dojçland GmbH nëpërmjet shitblerjes së aksioneve. Pjesa e mbetur prej 10.1% e aksioneve në Valldurn Grundstucks GmbH do të vazhdojë të jetë në pronësi të ALRE.

Valldurn Grundstucks GmbH nuk është e pranishme dhe e regjistruar në ndonjë korporatë në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk) dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

11.07. 2023

Shkup